



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 232, Datë 12.11.2019

PËR PJESËMARRJEN E PROKURORËVE NË AKTIVITETET TRAJNUESE TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

Në mbështetje të nenit 186, nenit 248/1, pika f), nenit 272/3, të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, nenit 5 të Ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, bazuar në kërkesën, informacionin dhe materialet e dërguara nga Shkolla e Magjistraturës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë pjesëmarrjen në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës, prokurorët e ftuar, për tre-mujorin e parë të vitit akademik 2019-2020.
2. Të miratojë pjesërisht listën e ekspertëve/ lehtësuesve prokurorë për aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës, sipas roleve të caktuara.
3. Kandidatët për prokuror në Prokurorinë e Posaçme (SPAK) nuk mund të marrin pjesë si ekspertë/ lehtësues në trajnime, për shkak të ngarkesave funksionale që do të bartin.
4. Për këtë vendim njoftohen Shkolla e Magjistraturës dhe magjistratët prokurorë, sipas listave dhe kalendarit të propozuar.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

GENT IBRAHIMI



Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga "Qemal Stafa" Nr. 1, godina e Prokurorisë së Përgjithshme, Tiranë

www.klp.al/ adresa e mail; info@klp.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 232, Datë 12.11.2019

PËR PJESËMARRJEN E PROKURORËVE NË AKTIVITETET TRAJNUESE TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

Në mbështetje të nenit 186, nenit 248/1, pika f), nenit 272/3, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenit 5 të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në kërkesën, informacionin dhe materialet e dërguara nga Shkolla e Magjistraturës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë pjesëmarrjen në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës, prokurorët e ftuar, për tre-mujorin e parë të vitit akademik 2019-2020.
2. Të miratojë pjesërisht listën e ekspertëve/ lehtësuesve prokurorë për aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës, sipas roleve të caktuara.
3. Kandidatët për prokuror në Prokurorinë e Posaçme (SPAK) nuk mund të marrin pjesë si ekspertë/ lehtësues në trajnime, për shkak të ngarkesave funksionale që do të bartin.
4. Për këtë vendim njoftohen Shkolla e Magjistraturës dhe magjistratët prokurorë, sipas listave dhe kalendarit të propozuar.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

GENT IBRAHIMI



Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga “Qemal Stafa” Nr. 1, godina e Prokurorisë së Përgjithshme, Tiranë

www.klp.al/ adresa e mail; info@klp.al